

# Mbledhja e Këshillit Bashkiak Kurbin

## Mbledhja e Shkurtit 2026.

**Data: 23.02.2026 Ora: 11:00**

**Mbledhja drejtohet nga: Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit**

1. "Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj Janar 2026".
2. "Projekt-vendim për miratimin e një ndryshimi në v.k.b nr 47 datë 19.12.2025 për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Kurbin dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtare 2026-208 si dhe numrit maksimal të punonjësve.
3. "Projekt-vendim për miratimin e një shpërblimi (mbeshtetje financiare) Grupit Artistik "Gurra e Kurbinit" nga fondi rezerv "2026. .
4. "Projekt-vendim për miratimin e kërkesës të bashkisë për mbeshtetje financiare nga fondi emergjencave civile të një familje për demet e shkaktuara në orendi dhe ana ndertimore ,paisje,si pasoje e djegjes së banesës në Sanxhak njesia administrative Laç .
5. "Projekt-vendim për miratimin e kërkesës të bashkisë për mbeshtetje financiare nga (fondi emergjencave civile dhe ai i kushtëzuar),për familjet e demtuara ,banesat e të cilëve u preken nga përmbytjet si pasoje e shirave në date 06-07 janar në territorin e bashkisë Kurbin.
6. Interpelancë me drejtorin e bordit të kullimit Lezhë për përmbyetjet ne territorin e bashkisë Kurbin.
7. Informacion për mbarimin e mandatit të Këshilltarit z.Diogjen Kolic.

-  
Të ndryshme .

**Të pranishëm: 20 këshilltarë në fillimin e mbledhjes**

**Pjesëmarrës nga administrata:**

- **Florian Paloka , nënkryetar i Bashkisë**
- **Dolfi Toma drejtori i sherbimeve publike**
- **BLENDAR GJIDIA specialist Emergjencave civile.**
- **Amarildo Buqpapa drejtori i taksave.**
- **Drita Kodra specialiste e taksave.**
- **Rake Kola, Drejtoria e Financave**
- **Llesh Ndoci, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike**
- **Jurgena Tuci drejtoresha e burimeve njerzore.**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit:** Fillojmë mbledhjen duke venë re numrin e Këshilltareve . Me rendin e ditës, besoj se jeni njoftë? A jeni dakord me rendin e ditës ?

**Miratohet rendi i ditës dhe procesverbali i mbledhjes të kaluar të gjithë dakort 20 vota kundra ska absternim ska**

Albert, kush është dakord, kush ka kërkesë? Antoni, Anton Kolziu.

Anton, po?

**Anton Kolziu;**A e keni listë prezencën E para. E dyta, aty ke .8 Sa pika janë ne rend dite që duhet të zbatohen sot? Sa pika ka rendi i ditës?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Rendi i ditës do të diskutohen të gjitha, do jenë të gjitha.

**Anton Kolziu;**Po sa pika janë? Sa pika janë aty?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Po je tu më pyet mu se sa pika janë? Sa pika ka?

**Anton Kolziu;**Jo, po kam 8 Në këto fletë vijnë në shtatë pika dhe vijnë të ndryshme. Atje në Facebook ju nxirrni se janë tetë pika.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Si në Facebook? I njëjti është. Arbër, është i njëjti njoftim.

**Anton Kolziu;**Po pra, po ajo e ndryshme është pika e tetë apo nuk është pikë e rendit të ditës? Sepse ka dy mbledhje që ju të ndryshme nuk i diskutoni këtu. Mbyllni mbledhje dhe ikni.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Të ndryshme, të ndryshme, unë ju pyes, a keni? O Anton, ta shihje rregullat, nuk je i veti. As ti as unë, as unë. Ajo është rregull. Tek të ndryshme mund të jetë dhe zero. S'kemi asnjë lloj detyrimi. Tek të ndryshme, unë ju pyes që është në fillim, kush ka me diskutu? Dhe në qoftë se ti ke diçka për ta diskutuar, nuk të kujtohet gjatë mbledhjes. E thu që është në fillim, e vendosim edhe kaq. Tashi, çfarë janë këto gjëra? Ti ke gjëra të ndryshme sot, do me diskutu diçka?

**Anton Kolziu;**Shiheni si prezencën tani, e ke ose se ke?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Arbër? Patjetër që jemi. Tashi, keni diçka për ta diskutuar tek të ndryshmet? Kush ka diçka që na del këtë mbledhje? Kush ka diçka për ta diskutuar tek të ndryshmet? A keni? S'keni? Jeni dakord me rendin e ditës? Kush është dakord? Po patjetër që e kam. 18 korumi? Po patjetër që e kam.

**Anton Kolziu ;**Ne po dalim

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** 18 Okay. Atëherë fillojmë me rendin e ditës. Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike. Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muajin janar 2026. A jeni dakord ta kalojmë ndihmën ekonomike?

**Shenim shtohen persëri 2 këshilltarë behen 20.**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;** Fillojmë. Sipas pikës së parë, projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj Janar 2026. Tashti, a ka nevojë për diskutim? Ta hedhim në votim. Kush është dakord? Kundër? **Miratohet.ndihma ekonomike 6% ,20 vota pro kunder ska absternim ska..**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit ;**Projekt-vendim. Tashi, ndajeni mendjen, çfarë do bëni? Ndajeni mendjen, se tashi... Nuk ju ka hije. Atëherë, projekt-vendim për miratimin e ndryshimit në VKB numër 47. Ju lutem, tashi, kur flas unë, po. Projekt-vendim për miratimin e ndryshimit në VKB numër 47, datë 19.12, për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë së Kurbin dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar, si dhe numrit maksimal të punonjësve. Rake. Urdhëro.

**Etmond Stojani;**Një pyetje. Po, një pyetje.drejtori i i Bordit të Kullimit, I agjencisë dhe I bashkisë ndodhen ne sallë?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit ;**Po, është. Sot është, sot Arbër. Po, është. Vazhdo, Rake.

**Rake Kola;**Përshëndetje. Si çdo vit në fund të dhjetorit të vitit, bëjmë përmbledhjen dhe përmbledhësen për fondet e trashëguara nga viti në vitin tjetër. Në zbatim të ligjit 139/2015 për veçorisën vendore, të udhëzimit të Ministrisë së Financave 23 për procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm dhe të akordimit më 10.02.2026, midis degës së saj dhe Bashkisë së Kurbin, fondet që mbarten, që trashëgohen në fund të vitit, në zbatim të ligjit, janë të trashëgueshme dhe mund të rifuten prapë në buxhetin e Bashkisë. Në zbatim të akordimit, fondet që ne trashëgojmë nga viti 2025 janë në vlerën 125.908.191. Meqenëse në buxhetimin fillestar në buxhet ne kishim parashikuar një fond prej 65 milionë për të trashëguarat e vitit 2025 dhe i kemi shpërndarë sipas buxhetit të miratuar, ngelen për t'u trashëguar dhe për t'u shpërndarë për vitin 2026, 60.908.191 lekë. Meqenëse këto fonde trashëgohen thuajse për të njëjtat objekte investime dhe shpenzime të vitit 2025, siç janë investimet për rrugët e njësisë administrative "Laç", investimet për rrugët e njësisë administrative "Milotë", investimet për rrugët e njësisë administrative "Mamurras", investimet për projektin e fituar nga Grandi i Performancës në vitin 2025, si dhe ca investime të tjera të cilat ishin marrë përsipër, janë kontraktuar, por zbatimi dhe likuidimi i tyre mbartet për 2025-ën. Ne kemi bërë një detajim të këtij fondi të trashëgueshëm nga viti 2025 në vitin 2026 dhe detajuar konkretisht për shpenzimet e përgjithshme operative në vlerën 32.866.000 dhe për investime dhe shpenzime dhe projekte 28.022.074. Ky fond i trashëguar futet prapë në skemën e buxhetit dhe trashëgohet për t'u shpenzuar sipas kontratave, marrëveshjeve të lidhura nga viti 2025, të cilat nuk kanë arritur të zbatohen ose të merren dorëzim për vitin 2025. Kjo është një panoramë e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit ;**Rake, mos e lexo deri në fund. Mendoj, kush ka pyetje? Kush ka gjë të paqartë? Çfarëdolloj gjëje që ka me sqaru? Rakja është këtu.

**Rake Kola;**Ne mbas zbatimit të ligjit 67/2015, të gjitha fondet që janë transferë të papushtëzuar për funksionimin e administratës së Bashkisë trashëgohen. Pra, kemi të drejtën me i trashëgu, me i marrë prapë mbrapsht dhe me i fut prapë në skenën e buxhetit për t'u rishpërndarë dhe për të bërë ekzekutimin dhe alokimin e fondeve sipas destinacionit të përcaktuar.

**Pashk Prenga;**Tani lidhur me këtë projekt-vendim për ndryshimin e zgjidhjes së gjatësisë numër 47, ju lutem, Bert, aman! E bën me diskutim në Komision të Ekonomisë. Realisht, nuk është përgjegjësi kurre e degës së financës dhe e Rakës, por urbanistika duhet me paraqitë një tabelë këtu, bashkangjitë këtij materialit për këto ndryshimin, për këto investimet, ke zë investime kryesore, ke zë investime, duhet me pasur zyrë urbanistikës cilat janë objektet. Me detaju fol me objekte konkrete, ta dijë çdo qytetar, të jetë transparent çdo qytetar se ku do të destilohen këto fonde.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit ;**Po, këto na e kanë sjellë fondin total, ti thu që të jetë i detajum shumë andej.

**Pashk Prenga;**Do të jetë i detajum, prapë. Ky materiali është shumë në rregull, por kjo tabelë duhet bashkangjitë. Rake. Këshill për radhës tjetër. Mos na sillni shuma totale, na i sillni shuma.

**Rake Kola;**Ta bëj një sqarim? Po. Atëherë, unë thashë, janë të trashëguara të gjithë ato projekte investimi të cilat janë kaluar në Këshill jo një herë, por dy herë. Janë kaluar në Këshill në dhjetor 2024 për investimet e 2025-s dhe janë kaluar vjet në dhjetor të 2025-s për rigrupimin e investimeve që i kemi rigrupuar. Shpenzime për asfaltim rrugësh në njësinë administrative "Laç", "Milotë", "Fushëkuqe" dhe "Mamurras". Ky rigrupim janë 19 projekte të cilat janë hedhur në tenderim në dhjetor 2025-ës, vazhdojnë procedurat e tenderimit dhe ky fond që ishte në 2025-in i disponueshëm për këto projekte, normalisht që duhet të mbartet dhe të trashëgohet në 2026-n për të likuiduar ato investime që do të kryhen pas zbatimit të kontratave dhe prokurimeve.

**Pashk Prenga;**Rake, tani, perashtojë veten nga kjo përgjegjësi, prej ashtu edhe nga kjo përgjegjësi dhe e tjetra. Ideja është kjo, ne kemi trashëgu vjet fondet të 2024-s që nuk arritëm me i vunë punë. Trashëgojmë vitet 2024, 2025, i kalojmë 2026-ën. Do na shkoni në 2027-ën. Të lutem shumë, një transparencë Këshilli e kërkon objekt për objekt. Pse ka qenë plan? Pse nuk është realizu? A është realizu? Pse s'është realizu? Po është objekt? Po është dhe objekt, Rake. Nuk është përgjegjësia jote, është përgjegjësia e urbanistikës. Të lutem shumë, mos merr përgjegjësi të huaja. Është përgjegjësi e urbanistikës. Objekt për objekt, të jetë e qartë, publiku të jetë këshilltari i qartë, të jetë publiku i qartë. Po është dhe objekt. Se po na pyesin që do të dalë në rrugë, zotëri, kjo rruga është planifikuar siç 2024 e mori ballë? O, Berti, se ka të bëjë!

**Rake Kola;**Unë këtu, të lutem, unë këtu vij për të trashëguar fonde, për një analizë fondesh të trashëguara. Kjo analizë për këto fonde që kanë ngelë pa u përfunduar, janë bërë në dhjetor të 2025-ës, kur kemi bërë analizën e buxhetit dhe kemi thënë 19 projekte investimesh për rrugët do të mbarten, sepse janë akoma në prokurim. Në dhjetor janë hedhur në prokurim. Po të 19 rrugët, me na i bartë çfarë? Objekt për objekt, të cilat janë të këto me tabelë, me tabelë, ta dijë çdo qytetar, ta dijë. Unë për të jetuar publiku, ke faqja e Këshillit, listën e objekteve që janë në Bashkinë e Kurbin për vitin 2026. Janë publikuar lista e investimeve, o shef, janë publikuar.

**Pashk Prenga;**O, Rake. Të lutem, shumë që s'është kjo përgjegjësi, se nuk e ke ti, aman, të lutem shumë. Për ta bërë kjo fjalë nga vetja ime, besoj se janë dakord edhe këshilltarët tanë.

**Rake Kola;**Unë po flas për përgjegjësinë time. Këto fonde që ne në fund të vitit i trashëgojmë, nuk i kemi shpenzuar, është detyrim ligjor për t'i mbartur në vitin pasardhës. Kjo është përgjegjësia ime. Unë kam bërë një raportim me thesarin më datë 10.02.2026 dhe kam ardhur këtu për të thënë kaq fonde kanë tepruar nga 2025-ta dhe normalisht që unë do t'i fus prapë në skenë buxhetin 2026 për t'i ekzekutuar. Këto janë procedura. Prokurimi vonojnë, kjo nuk është në dorë tonë.

**Albert Ndoci;**Të jetë sa të vijë fushata, kjo dihet. Të vijë fushata, tre muaj përpara do i hedhim, po të keni bërë bulmet pasak. Dilni shumë herë se nuk jep kvota. Fati është zoti i pashëm. Asullat është zoti i pashëm. Kë dihet, i ka tre muaj përpara, pesë muaj se ndoshta ai e tenderoj e do me marrë votat. Po s'ka burrë gjallë në Shqipbanë, ta them për t'i vjellë që tash ka në vjellë, pa marrë nuk bëhet fjalë. Je duke punë që aplik tyn e marr. Çfarë do të bësh? Për të blerë Shqipërinë, kanë dëshiruar.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit .O, Bert! O, Alber! O, Alber! Albert, mos fol pa radhë, Albert. Mos fol pa radhë. Mos fol pa radhë. Pyetje tjetër. Pyetje tjetër, e hedhim votim. Kush është pra? Kush është pra? Kush është kundër? Luigj, të lutem, ulu. Kush është kundër? ?Arbër , numëroja ato votat, aman. Miratohet me 16 vota pro 4 kunder 0 absternim "Projekt-vendim për miratimin e një ndryshimi në v.k.b nr 47 datë 19.12.2025 për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Kurbinit dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtare 2026-208 si dhe numrit maksimal të punonjësve.**

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Okay, Projekt-vendim për miratimin e shpërblimit grupit artistik "Gurra e Kurbinit" nga fondi rezervë 2026. Rake. Ti do e referosh. Mikrofonin e kam ndalur, Albert. Jo, vetëm kur të kesh radhën me fol. Vetëm kur të kesh radhën me fol. Vetëm kur të marrësh drejtën e fjalës. Vetëm kur të marrësh drejtën e... Po, po, Rake, të lutem, vazhdo.

**Rake Kola;**Kërkojm se për mbështetje financiare për grupin "Gurra e Kurbinit", të hartuar nga Pallati i Kulturës dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve, ku jepet një relacion përmbledhës për aktivitetet që janë zhvilluar nga ky grup artistikë, kërkohet nga ana e këtyre që të japim, t'i mbështesim me një fond minimalist, mund të them unë, me një vlerë prej 10.000 lekë për person, për të gjithë grupin aktivizuar në grupin "Gurra e Kurbinit". Këtë ne kemi menduar që t'ia u shpërndajmë këtyre personave sipas listës së bashkëlidhur. Besoj që listën e keni bashkëlidhur të gjithë dhe 10.000 lekë për person. Pyetje? Sqarim? Po, Laurin. Është pak, por meqenëse për momentin kaq kishim në dispozicion, se fondi është... Faleminderit. Tash ti ka pyetje Laurini. Po.

**Laurin Sana;**Faleminderit, kryetare. Dhe ndërruam koleg këshilltar. Më vjen shumë mirë që merret ky hap. Është shumë e pakët. Pse mos t'i jepshit më shumë, domethënë? Po, pyetja ime është: çfarë kriteri duhet me plotësu si artist për me marrë një ndihmë financiare nga bashkia? Se edhe unë jam artist i këtij vendi, krye aktivitetin si artist i lirë. Edhe s'kam pas asnjë lloj ndihme. Ose ka ndonjë plan konkret për artistat? Sepse janë plan shumë më të mëdha.

**Rake Kola;**Edhe me në referimin që i bëra. Unë kam një kërkesë nga Pallati i Kulturës dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve, nga dy drejtorat, të cilët më kanë bërë një rezumë dhe një përmbledhëse për të gjithë personat e aktivizuar në aktivitetet e "Gurrës së Kurbinit", për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete që kanë bërë edhe në bashki, edhe në përbashkësi të tjera,

edhe në median top channel e me radhë. Unë kam një listë që nuk mund të hedh poshtë firmat dhe vulat e këtyre personave drejtues që më thonë këta persona janë aktivizuar. Ne kemi menduar t'i mbështesim. Janë të gjithë aktivitetet vullnetar, sepse nuk janë të punësuar.

**Laurin Sana;**Unë jam shumë dakord. Nuk thashë pse i kemi mbështetur.

**Rake Kola;**Janë kontribues vullnetar dhe ne i kemi mbështetur me 10.000 lekë të re për momentin, sepse aq kemi fond rezervë dhe nuk është se kemi fond në vlerë maksimale. **Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Pyetje? Po. Aida. Aida Skeja.

**Aida Skeja;**E Ndëruar kryetare, të ndëruar koleg. Unë një pyetje kam lidhur me këtë fondin që është dhënë për artistët "Gurra e Kurbinit". Do të sugjeroja, këtu nuk pashë, do të sugjeroja që edhe ata fëmijë të cilët janë pjesëmarrës, pse jo, të mos ishin në këtë? Janë? Ka dhe fëmijë?

**Rake Kola;**Lista është prej 38 vetave, unë nuk është se identifikoj se cilët janë dhe të shpallojmë. Pse? Për shkak dy drejtorat që mua më kanë firmosur dhe më kanë sjellë. Kush ka qenë pjesë? Në rregull. Vetëm për këtë, se nuk është se mendova duke qenë pjesë e grupit artistik, thashë mbase janë vetëm thjesht stafi.

Pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë dhe në aktivitete dhe në përgatitjet.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Po Sefedin Lika

**Sefedin Lika;**Atëherë, këtu e keni shkruajtur "Gurra e Kurbinit". Kurse Edi Manushi tha "Gurra popullore" atje. Pse e keni? E dyta, e dyta, kur të lika dhurata, do t'i pranoj, thuhet 100.000 lekë, thu, apo t'i vaja, edhe unë na i xhan tjetër mashkull. Dy këngëtarë më të fuqishëm me 100.000 lekë, a s'është ulje? Edhe e treta, edhe e treta, a keni futur si kurbin? Se kurbin shkon deri në Krujë, deri në Shkëmb të Vajzë, kënohet kënga. Pse s'na keni futur ndonjë prej Krujës, prej Milotia? Se i kam parë emrat, i kam studiu, edhe i keni futur? Ja, i kam shkruar këtu edhe adresat, ku janë e kurrin, e krejt. I keni bërë ca dallime? Pse mos ma e fut kurbinin ashtu siç është Kurbinin?

**Rake Kola;**Për këtë kërkesë, po mbështetje financiare për grupin "Gurra e Kurbinit", drejtuar bashkisë Kurbin, kryetares së bashkisë Kurbin, nga Pallati i Kulturës dhe nga drejtorja e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, në të cilat bëjnë një rezumë për aktivitetet që ka zhvilluar ky grup prej 38 vetësh dhe për provat që kanë krijuar dhe që kanë bërë në vitin 2025 deri në shkurt 2026-s. Këtu janë përfshirë të gjithë personat që janë marrë me prova dhe me aktivitete. Vlera prej 10.000 lekësh, që është dhënë sepse është parë fondi rezervë, i cili është miratuar në buxhetin e bashkisë në vitin 2025-2026, dhe ai fond rezervë presupozon që do mbulojë të gjitha problemet që mund të kenë ose mund të hasin për 12 muaj. Pra, nga janari 2026 deri në dhjetorin 2026. Ne menduam që do japim 10.000 lekë për momentin, sepse aq mundësi kishim, sepse fondi dhe detajohet ndër muaj dhe limiti i thesarit aq na lejonte. Ata mund të meritojnë më shumë, kur të lika meriton shumë më shumë, sepse përfaqëson krejt Kurbinin, por mundësitë ekonomike, financiare të bashkisë Kurbin për momentin aq ishin.

**Sefedin Lika;**Atëherë, siç keni futur këto përmbytjet, një anë 2.800, tjetrit 500, edhe aty do të kishim bërë dallime?

**Rake Kola;**Jo, ky është një grup artistik që kanë marrë pjesë non-stop, kur i thonë në prova, në prova dhe në për aktivitete, dhe në për aktivitete në zona të ndryshme, dhe ne nuk mund t'i dallojmë. Njëri ka dhënë, njëri është lënë më shumë dhe tjetri është lënë më pak. Nëse i kurdis ka vështirësi për të marrë ato lekë, i kemi shpërndarë në uniforme për të gjithë. Sepse edhe sikur t'i kishim bërë ashtu siç thua ti, prapë do kishte atë mbetje, e do të thoshte dikush tjetër, do të kishte dhënë më pak e atij më shumë.

**Etmond Stojani;**A mundem?

Atëherë, jam dakord me kolegët që meritojnë më shumë këngëtarët, qoftë të rinj, qoftë...

**Rake Kola;**Do të mësojmë edhe ne, meritojnë më shumë, por aq mundësi kishim.

**Etmond Stojani;**Po, me këtë kërkesën që të ka bërë ajo Qendra e Kulturës, nuk jemi njoft, ne nuk e kemi. Kemi vetëm thjesht një miratim të kryetares së bashkisë.

**Rake Kola;**Qendra Kulturore ja ka bërë kryetares së bashkisë dhe bashkisë për të parë nëse kemi mundësi, fond apo s'kemi. Dhe këtu rezumohet në sa aktivitete kanë marrë pjesë. Në sa aktivitete kanë marrë pjesë, ma merr mendja, që jo vetëm këshilltarë, por krejt komuniteti është njohur sa herë që janë bërë aktivitete edhe në Kurbin, edhe në Top Channel, edhe nëpër rrethe tjera.

**Agron Ivani ,** Pjetër Nimanaj, ky ma merr mendja që ky është Pjetër Matusha. Lexoj i çik? Është i treti. E ka Nimanaj. E ka Nimanaj? Absolutisht që kjo është për t'u falënderuar, por unë do të sigurohem duke pasur parasysh...

**Altin Bruka;**A mundem një sekondë? Duke patur parasysh që këtu është e një listë nxënësish, që unë jam mësuesi i tyre, dhe do ishte mirë që herë tjetër drejtori i Pallatit të Kulturës të bëjë një propozim përpara aktiviteteve, sepse për nxënësit, unë mendoj kjo shumë është shumë e vogël për atë që ata na kanë përfaqësuar ne. Po, realisht është shumë e vogël. Unë jam në dijeni, sepse kam shumë nxënës të cilët kanë bërë dhe mungesa mësim edhe janë lodhur. Dhe do ishte mirë që drejtori herë tjetër, përpara aktiviteteve, ta sjellë si propozim si listë, dhe nuk kanë arsye se pse nxënësit të lodhen të udhëtojnë gjithë natën, edhe lodhen dhe shkatërrohen për shkak të fondeve. Pra, drejtori herë tjetër për aktivitetet e tilla, të cilët e kanë nderuar Kurbinin, duhet ta bëjë si liste përpara propozim me një listë të detajuar për shpenzimet që edhe ata kanë. Të na përfaqësojnë ashtu si duhet me energji të plota. Kështu që kjo është për t'u falënderuar. Dhe për sa i përket pjesëmarrjes, unë e di se pjesëmarrja me informacionin që ka qenë, ka qenë e lirë. Domethënë, janë këtu kush ka pas dëshirë dhe ju është thënë që është vullnetare. Nuk është se janë bërë me lista të përcaktuara. Faleminderit.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit Faleminderit.** E hedhim votim. Kush është dakord? Kush është kundër? Atëherë miratohet. Me një vote kunder 0 absternim dhe 19 vota pro "Projekt-vendim për miratimin e një shpërblimi (mbeshtetje financiare) Grupit Artistik "Gurra e Kurbinin" nga fondi rezerv "2026. .

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Po, kryetare.

**Erisa Gjoni;**Po, kisha dhe diçka tjetër. Atëherë, mar shkas nga gjendja që ndodhet, zonja e Denata Oroshi ose Haliti, unë kërkoj nga bashkia Kurbin t'i japim një mbështetje financiare. Gjithashtu, edhe këshilli do ishte mirë që t'i jepni një mbështetje zonjës në fjalë. Besoj e njihni se kush është.

**Altin Bruka;**Shumica nuk e njohin, nëse duan unë mund të bëj një raport për to, sepse një familjarisht bëj me fëmijët dhe me të gjitha. Nëse kanë nevojë për një raport të detajuar, unë personalisht mund ta bëj siç.

**Erisa Gjoni;**Pikërisht. Nëse prandaj thashë, nëse nuk e njihni, mund të bëjmë një raport, mund ta dimë krejtësisht.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Ajo është një gjendje shumë të vështirë shëndetësore, ekonomike. Kushdo që do të kontribuojë vetë personalisht, është i mirëpritur. Edhe bashkia mendoj që do ta bëjë pjesën e vet. Bashkia e bëjë pjesën e vetë, por edhe ne si këshill, shtëpia është rindërtuar. I është rindërtuar shtëpia?

**Altin Bruka;**Jo, jo, është pa shtëpi, është pa të ardhura, të gjitha shpenzimet që po për shkak të kurimit që ka shëndetit, domethënë të gjitha thjesht janë çështje ndihme. Prandaj do të ishte, për mendimin tim, do të ishte mirë që pak nga ana tjetër të nxjerrim një përshkrim për të dhe sa është e mundur edhe bashkia dhe sa është e mundur edhe.

**Erisa Gjoni;**Flas, është mirë që ne si këshill ta kalojmë tani, se vetë gjendjen që ka ajo nuk i dihet se çfarë mund të ndodhë ose jo.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Ne si këshill mund të kontribuojmë personalisht. E bashkia pastaj ndoshta na e sjell mbledhjen tjetër.

**Altin Bruka;**unë mendoj një propozim të shpenzimeve. Prandaj them, nuk është thjesht ideja në qoftë se ne ta ndihmojmë, ta ndihmojmë ta kryejë një çështje që ka për të kryer. Prandaj them, ne të ulemi dhe ta propozojmë. Mund ta marrim në detaje me koston mujore që ajo do të heqë një X çështje, sepse është i ka shumë të rëndë realisht. Dhe sa prej asaj ne mund të mbulojmë.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së bashkisë për mbështetje financiare nga fondi i emergjencave civile të një familje për dëmet e shkaktuara në rendi dhe anën ndërtimore, pajisje si pasojë e djegies së banesës në Sanxhak, njësia administrative Laç. A është kjo që tha Etdmond Stojani radhës tjetër?

**Etdmond Stojani;**Njëra nga të dyja.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Bravo Mond , shumë efikas. Veç t'u desh me e thanë, tak e kalojmë mbledhje.

**Etdmond Stojani;**Jo, diçka është e sigurt. E dimë më mirë ne këshilltarë të rrenin sesa kryetari i bashkisë ose specialistat, drejtuesit e zyrave apo çfarë janë. E njohim shumë më mirë ne të rrenin. Nuk ka herë mbyllim ndonjë sy, mbyllim ndonjë vesh.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Vazhdojmë. Po, Bledi.

**Bledi Gjidia;**Atëherë për sqarim, se unë fola dhe mbledhjen e kaluar fola... Keni prapë tjetrën, ju bëj thirrje, prapë keni tjetrën. Unë jam i hapur siç i duhet që t'i bëjmë. Unë kam punoj në terreni. Edhe për rastin fjalë që unë e përgatita sot dhe e kam sjellë, të thashë si ka qenë procedura. E para që shkon në vendngjarje është shërbimi i zjarrfikësve. Dhe unë e marr në moment njoftimin që më bën ai. Në momentin që ai më thotë që kjo shtëpi nga verifikimi vizual është e braktisur, unë nuk mund të filloj procedurën. Sugjerimi jot.

**Etmond Stojani;**Nëse shtëpia është e braktisur, si mori flakë? Kush e vuri flakën?

**Bledi Gjidia;**Jo, jo, këtu ndahen. Edhe për tërmetin i nderuar, nëse shtëpia nga inxhinieri verifikohet.Shiko, shtëpia e braktisur do të thotë që ti ke një objekt tjetër dhe unë si shtet nuk kontribuoj ty për dy shtëpi. Që ta kesh parimin kryesor i mbrojtjes civile dhe i kontributit që jep shteti. Kjo është një letër për të diskutuar pastaj e braktisur si pse apo jo. Por, duke qenë se ti e çove si problematikë, të na jetë gati në dispozicion, unë verifikoj. Jo, më nuk kam, unë e kam detyrë. Unë mund të kisha shkuar qysh momentin e parë që ka rënë zjarri.

**Etmond Stojani;**Shihni ato syrtarët, hapni syrtarët, mos t'ju zëmë plon se keni raste të tjera. Edhe një minimum i një raste të tillë.

**Bledi Gjidia;**Nuk ka shanse. Nuk ka shanse raste të tjera. Është ai rasti i dytë që më ke thënë ti, ta kam thënë ku është problemi, ndërsa ta ndajmë tashti ai që ka detyrimin ligjor ta verifikojmë terren që është i njëësisë dhe të më thotë po, atëherë do filloj procedurën. E gjitha këtë unë prapë do ta marr përsipër vetë, sepse tash kështu ka ngelë kjo punë, shkoj unë ta gjej të gjithë Kurbinin. Gjë që.Po, poshtë kësaj. Atëherë bëhet fjalë për një banesë që pronar ka kastriot korrikun, aktualisht nuk jeton këtu, por kjo nuk ka rëndësi. Është bërë procedura standarde që ndjekën gjithmonë me urdhër të kryetarit. Verifikimi në terren, janë foto të objektit që janë konstatuar në momentin e zjarrit. Preventivi nga ana ndërtimore, preventiv në dëmet në pajisje dhe orendi. Ka një specifikë ky rast, sepse janë ndarë jo pa qëllim dëmet në orendi dhe pajisje nga dëmet në strukturë. Aty ka qenë një familje me qera dhe logjikisht për të anashkaluar dhe problematikat që mund të lindin nesër pasnesër, janë verifikuar të gjitha, janë marrë vesh me njëri-tjetrin të dy, edhe pronari, edhe ose dosja e pajisjeve dhe orendit, dhe është ndarë preventivi specifikisht për secilin përfitues. Pra, preventivi nga ana ndërtimore e merr pronari i shtëpisë, ndërsa vlerën e dëmeve të pajisjeve dhe orendive që janë të qiraxhiut i merr qiraxhiu. Okay, unë për... Kush ka një paqartësi?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**E hedhim votim. Kush është dakord? Kundër?

**Bledi Gjidia;**Sa për rastin tjetër, mundi? Më duhet një kërkesë të më bjerë dikush në zyrë. Meqenëse nuk...

**Etmond Stojani;**Specifikoj një kërkesë e dytë, sepse të parën e keni me numër protokolli dy sekonda, sa ta gjej pak. E protokollon në sekretarinë e bashkisë me datë 25.11.2025 me numër protokolli 5605. Nëse duhet e dyta, orientoj qytetarin, të vihet bëhet dytë.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Atëherë, mjafton. Tashti, Bledi, do kalojmë te pjesa tjetër, do sqarohesh me këshilltarin. Jo kërkesa, gjejeni ku është edhe sqarohuni. Do kalojmë te pika tjetër. Miratohet me 19 vota pro 0 absternim 0 vota kunder Projekt-vendim për miratimin e kërkesës të bashkisë për mbeshtetje financiare nga fondi emergjencave civile të një familje për demet e shkaktuara në orendi dhe ana ndertimore ,pajsje,si pasoje e djegjes së banesës në Sanxhak njesia administrative Laç .Sqaroje vetëm me këshilltarin që është ndjenitë të kësaj pune.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Projekt-vendim për miratimin e kërkesës së bashkisë për mbeshtetje financiare nga fondi i emergjencave civile dhe ai i kushtëzuar për familjet e dëmtuara, banesat e të cilëve u prekën nga përmytjet si pasojë e shirave në datën 6-7 janar në territorin e bashkisë Kurbin.

**Bledi Gjidia;**Atëherë. Të gjithë ne e dimë që kaluam një periudhë të vështirë me datën 6-7 janar si rezultat i reshjeve intensive. Për këtë shkak krijuan problematikat që e dimë ne tradicionalisht ku janë zonat e riskut në bashkinë Kurbin. Por në ndryshim nga përmytjet e Nentorit, në këtë rast harta e riskut ishte goxha më e madhe, sepse edhe reshjet ishin të tilla që nëse dikush do ta dijë, kanë rënë 200 milimetra vetëm për 6 orë, është e papërballueshme për kapacitetin e të gjithë sistemit të kanalizimeve dhe kanaleve kullues, jo vetëm për Kurbinin, por për gjithkënd. Në këto kushte është ngritur urdhri i kryetares së bashkisë, janë ngritur katër grupe pune për çdo njësi administrative. Në bazë të ankesave, kërkesave edhe telefonatave që banorët vetë kanë bërë, grupet e punës kanë krehur të gjithë terrenin e të gjitha zonave të përmytura. Në projekt-vendim keni një tabelë përmbledhëse, ku tabela e parë është vlera totale e mbledhur nga çdo njësi administrative. Keni tabelën e dëmeve dhe familjeve të dëmtuara në njësinë Mamurrës të njësisë administrative Laç dhe të njësisë administrative Fushëkuqe. Miloti ka pasur vetëm një rast këtë rast. Tabelat janë, praktikat e plota ja ku janë aty, dikush nga ju mund t'i vejë, gishti një emri këtu, hapim dosjen ta shohim, por ka qenë e pamundur fotokopja e 101 praktikave për shkak të shpenzimeve kolosale. Origjinalet me gjithë dy kopje janë në tavolinë, gjithkush nga ju është i hapur t'i verifikojë. Janë të shoqëruara me foto, sepse verifikim e të gjitha.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Pyetje ?

Po, Sefedin .

**Sefedin Likaj;**Atëherë, komisioni verifikues është këtu sot?

Komisioni që ka bërë verifikimin e banorëve të shtëpive është aktiv sot? Është këtu prezent.

Komisioni, a ke ndonjë komision këtu në prezent?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Prezent kemi një nga specialistët, është Flori nga anëtarët.

**Sefedin Likaj;** Atëherë, atëherë ti the vetëm një rast, Milot.Të shihni njesia administrative Milot, deri ku përfshihet? A e di ti? Hë, kap deri ku fillon autostradën, poshtë autostradës? A e keni verifikuar Shullasin ju?

**Bledi Gjidi**;Tashi, që mos t'i ngatërrojmë gjërat ne këtu kemi vetem shtepitë jo tokat bujqësore..

**Sefedin Likaj**;Ti the Milot vetëm një. Edhe ai konflikt sa është hyrje pallati, më duket më than. Ju qofshi bekuar me dalë me ne ato ditë, sepse jeni përfaqësues të komunitetit, po ne... Po pra, unë do të bëj pyetje, ti do të më përgjigjesh. Mbaroj unë më mirë. Po pra, sepse nuk jam tu thënë se X, Y, po dyshojmë edhe ne më. Se janë njerëz të afërt të.Tashi, i kena lexuar emrat, se s'kena se më tha i koleg mu se ashtu ku mira, se s'ja qes emri unë, se... Pra, unë e tha, s'mund të fol unë, tha. Ju e thashë se fol unë? Okey Të shih si fol unë. Unë them, hajde t'i marrim këto një nga ata pesë të opozitës edhe të shkojmë njëherë t'i verifikojmë, se janë 100 e kusur milion lekë, o shoku jonë. Sigurtë i kishin bërë investim ju, s'u përmbytën njerëzit. Po, pse? Pse vetëm shiu i janarit? Keni futur ju po përmbytje të tjera si u përmbyt dyqani në Zhejë?

**Bledi Gjidi**;Se ja kupton nga njëherë që unë kam ndenë të sqaroj, po ti nuk e dhe nuk... Mirë se s'din. Edhe herë, unë bëj pajisjet, orendi, dëmet ç'është të futet uji brenda shtëpisë. Kultura bujqësore i vlerson tjetër kush.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Bledi, të lutem, Bledi, Bledi, të lutem.

**Sefedin Likaj**;E ke Kurbinin, e ke Kurbinin këtu, ja 3 milion e 837 mijë lekë, 38 milionë të vjetra. Mos i shih këto lekë, po bëj shifim me ne emra, mos bëj.Mos keni futur tani, mos na keni futur tani, hyrje pallati. Na thoni, ka nevojë për lekë, jepja, po të paktën na thoni.

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit** Kjo nuk është bisedë për t'u bërë ajo. Pyetje tjetër, pyetje tjetër. Aida, Bledi, të lutem, Bledi.

**Aida Skeja**;. Për një emër, është Vladimir Skana, se nuk e pashë këtu të dyja herët.

**Etmond Stojani**;Lazër, Lazër, Lazër. Jam interesu dhe unë, është Lazër. Kush është ai? Atëherë, në lidhje me këto përmbytjet, pasi u njohën materiale, rezulton se ka dhe familje të tjera të përmbytura dhe të papërfshirë në lista. Minimumi dy emra i kam nga Mamurësi, Lek Gjini dhe Agim Gashi. I keni futur tre. Prit, prit. Jo, nuk është Agimi. Domethënë, janë krejt ato që janë nën një kulm me Agimin dhe Agimi nuk është.

**Bledi Gjidi**;Është dhe Agim Gashi.

**Etmond Stojani**;Se janë... Na emri i Agimit tërhiqen. Po, pyetja është, a janë, a ju ka shku komisioni derë më derë apo vetëm kush është anku te bashkia? E kam përgjegjësi, jo vetëm, jo vetëm për...

**Bledi Gjidi**;Të gjithë administratorët, të gjithë punonjësit e terrenit janë njoftuar. Në momentin që është bërë verifikimi paraprak, që çdo familje që ka dëme në orendi, në pajisje, qoftë edhe kultura bujqësore, të bënte një kërkesë, qoftë edhe me telefon. Unë kam, plot kërkesa që është, që i kam akoma në zyrë sot, që i kam bërë me kërkesë, i ka lënë te sekretaria poshtë dhe unë update-oja listat çdo ditë me grupet e komisionit. Por unë kam bërë një testim. Deri më sot, përveç një familje që më ka ardhur, ajo kishte kultura bujqësore, nuk më ka ardhur askush të më thotë që ti s'ke ardhur te shtëpia ime.

**Etmond Stojani;**Të kuptoj. Edhe, edhe një pyetje tjetër. Ëh, familjet që kanë pas dyrët e mbyllur, sigurisht rasti i Kastriot Korrikut, familjet që e tërë janë jashtë shteti dhe kanë pas dyrët e mbyllur me a janë verifikuar apo si funksionon?

**Edlira Lleshi Kryetare e Këshillit;**Po, se verifikon dot qoftë se është dera mbyllur si? Nuk është e mundur, sepse nuk futen dot është logjike, tash me derë të mbyllur, çfarë do t'i bësh?

**Bledi Gjidia;**Shiko, dëmet janë ç'ka ke si je brenda banesës, mundje.

**Bled Gjidia;**Po, se po do të bëjmë jashtë afateve kohore, se nuk është problemi për dy, tre veta. Ne kur kemi bërë 100.
